

UDHËZUES

për përdorimin e logove në kuadër të aktiviteteve të programit SENIOR-A

Të gjitha shoqatat OSHC-të, të cilat kanë pëfituar Marrëveshje për Ndihmë (Grant) në kuadër të Programit SENIOR-A dhe që do të përdorin logon e programit, të REC dhe të Qeverisë Suedeze, duhet të kenë parasysh kushtet e mëposhtme:

- 1) **Publikimi i ftesave, programeve (axhendave), fletëpalosjeve etj** (edhe në format elektronik).
 - a) Logot e REC dhe të Qeverisë Suedeze duhet të jenë të vendosura afër njëra tjetrës dhe në të njëjtën madhësi. Anash tyre (por jo në mes të tyre) mund të vendoset dhe logo e Shoqatës, e cila duhet të ketë të njëjtën madhësi me logot e REC dhe të Qeverisë Suedeze. Logot së bashku nuk mund të jenë më të gjera se 40% e gjerësisë së dokumentit.
 - b) Logo e Programit SENIOR-A duhet të vendoset në anën tjetër të dokumentit p.sh. nëse logot e REC, Qeverisë Suedeze dhe të Shoqatës janë në pjesën e sipërme të dokumentit (*header*) logo e programit duhet vendosur në pjesën e poshtme (*footer*) apo anasjelltas. Do të ishte e këshillueshme që dhe logo e programit të jetë në të njëjtën madhësi si logot e mësipërme.
 - c) Në rastin e shprehjes së falenderimit do të përdoret kjo shprehje:


Mbështetje për Organizatat Mjedisore
të Shoqërisë Civile në Shqipëri

TRAJNIM
“Vlerësimi i Ndikimi në Mjedis dhe Roli i Shoqërisë Civile”
me përfaqësuesit e shoqërisë civile
Hotel “Mondial”, Tiranë
29-30 Prill 2013

Dita e Parë	
PROGRAMI	
09:00 – 09:15	Regjistrimi i pjesëmarrësve dhe kafa e mëngjesit
09:15 – 09:30	Hapje e takimit – Mirësevërdhja Prezantimi i pjesëmarrësve dhe i programit të trajnimit
Sesioni i parë	
09:30 – 10:45	Legjislacioni mbli VNM-në, procedurat dhe institucionet përgjegjëse Shembuj praktikë VNM-je për aktivitetet të ndryshme Klodion ALIU, Drejtorja e Kërkimeve të Mjedisit (MMPALU)
10:45 – 11:15	Pyetje dhe diskutime
11:15 – 11:30	Pushim Kafaje
Sesioni i dytë	
11:30 – 13:00	Procesi i VNM-je (Shqyrtim, akordim dhe ndihmë) Shembuj konkretë të zbatimit të një VNM-je Erieva ÇAVAJ, eksperte për VNM-je
13:00 – 14:00	Dreka
Sesioni i tretë	
14:00 – 16:00	Punë në grupe: Proceset e hartimit të një VNM-je Erieva ÇAVAJ, eksperte për VNM-je
16:00 – 18:30	Vlerësimi dhe mbyllja e ditës së parë të trajnimit

 

“Ky projekt është bërë i mundur nga një grant i REC në kuadër të programit SENIOR-A “Mbështetje për Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri”. Ky program është financuar nga Qeveria Suedeze”

- 2) **Publikimi i artikujve, manualeve apo botimeve të ndryshme etj**, (edhe në format elektronik).
- a) Logot e REC dhe të Qeverisë Suedeze duhet të jenë të vendosura afër njëra tjetrës dhe në të njëjtën madhësi. Anash tyre (por jo në mes të tyre) mund të vendoset dhe logo e Shoqatës e cila duhet të ketë të njëjtën madhësi me logot e REC dhe të Qeverisë Suedeze. Logot së bashku nuk mund të jenë më të gjera se 40% e gjerësisë së dokumentit.
 - b) Logo e Programit SENIOR-A duhet të vendoset në anën tjetër të dokumentit p.sh. nëse logot e REC, Qeverisë Suedeze dhe të Shoqatës janë në pjesën e sipërme të dokumentit (*header*) logo e programit duhet vendosur në pjesën e poshtme (*footer*) apo anasjelltas. Do të ishte e këshillueshme që dhe logo e programit të jetë në të njëjtën madhësi si logot e mësipërme.
 - c) Në rastin e shprehjes së falenderimit do të përdoret kjo shprehje:

“Ky botim është bërë i mundur nga një grant i REC në kuadër të programit SENIOR-A “Mbështetje për Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri”. Ky program është financuar nga Qeveria Suedeze”

- d) Në çdo rast do të përdoret dhe ky paragraf (*disclaimer*):

“Ky botim u mundësua nga një grant i dhënë nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri përmes programit SENIOR-A. Ky publikim paraqet pikëpamjet e autorit/autorëve mbi këtë temë. Këto pikëpamje nuk janë adoptuar apo aprovuar nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) dhe nuk duhet të shihen si qëndrime të REC apo të Ambasadës Suedeze në Shqipëri. REC Shqipëri nuk garanton saktësinë e të dhënave të këtij publikimi e nuk mban përgjegjësi për përdorimin e këtij publikimi.



Mbështetje për Organizatat Mjedisore
të Shoqërisë Civile në Shqipëri

3) Publikimi i banerave, posterave në format të madh etj.

- a) Logot e REC dhe të Qeverisë Suedeze duhet të jenë të vendosura afër njëra tjetrës dhe në të njëjtën madhësi. Anash tyre (por jo në mes të tyre) mund të vendoset dhe logo e Shoqatës, e cila duhet të ketë të njëjtën madhësi me logot e REC dhe të Qeverisë Suedeze. Logot së bashku nuk mund të jenë më të gjera se 40% e gjerësisë së dokumentit.
- b) Logo e Programit SENIOR-A duhet të vendoset në anën tjetër të dokumentit p.sh. nëse logot e REC, Qeverisë Suedeze dhe të Shoqatës janë në pjesën e sipërme të dokumentit (*header*) logo e programit duhet vendosur në pjesën e poshtme (*footer*) apo anasjelltas. Do të ishte e këshillueshme që dhe logo e programit të jetë në të njëjtën madhësi si logot e mësipërme.



Shënime të rëndësishme:

Logot që gjenden në Shtojcën 1 përdoren vetëm për materialet në word, si ftesa apo programe. Për çdo botim tjetër të shtypur logot duhet të jenë në format vektorial (format .eps) të cilin duhet ta kërkontë paraprakisht pranë REC Shqipëri.

Për çdo informacion apo paqartësi që keni, ju lutem kontaktoni zyrën e REC Shqipëri përpara se të filloni publikimin e materialeve.



Mbështetje për Organizatat Mjedisore
të Shoqërisë Civile në Shqipëri

Shtojca 1

Logot që do të përdoren në kuadër të programit SENIOR-A

1. Logo e REC Shqipëri



QENDRA RAJONALE E MJEDISIT
Shqipëri

2. Logo e Donatorit (Qeverisë Suedeze)



3. Logo e Programit SENIOR-A (në shqip)



Mbështetje për Organizatat Mjedisore
të Shoqërisë Civile në Shqipëri

4. Logo e Programit SENIOR-A (në anglisht)



Support for Environmental
Civil Society Organisations in Albania